

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-095/14

Prishtinë

10 Dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

D.dhe B.D.

Pala ankuese

Kundër

**L. M.
Klinë**

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Esma Erterzi, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA26258) të datës 27 nëntor 2013, pas seancës të mbajtur më 10 Dhjetor 2014 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. dhe B. D;
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/224/2013 i datës 27 nëntor 2013 për sa i takon lëndës të regjistruar me numrin KPA26258.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datën 6 mars 2007, D. D. (tani e tutje: paraqitësja e kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës në emër të bashkëshortit të saj B. D. në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore ku kërkon ri-posedim të pronës së paluajtshme e cila ndodhet në Komunën e Klinës, ngastra nr.1933/2 me sipërfaqe prej 00.14.29 ha me dyqanet afariste me sipërfaqe prej 480 m² që ndodhen në këtë pronë. Ajo thekson se e ka humbur posedimin mbi pronën e paluajtshme për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/99 që ka ndodhur në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, Paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar në AKP dokumentet vijues:
 - Certifikatën e martesës të lëshuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, Komuna e Kragujevcit më 14 gusht 1966 në emër të D. D, e cila vërteton se B. D. është bashkëshorti i saj.
 - Vendimin nr. 04-313-6 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, Drejtorati për Ekonomi, Strehim dhe Shërbime Publike më 20 shkurt 1979, ku i jepet e drejta Paraqitëse së kërkesës për të hapur dyqan si zejtar privat.
 - Vendimin 03.No.313-346 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, Drejtorati për Industri dhe Financa më 18 shtator 1996, ku vërtetohet leja për Paraqitësen e kërkesës për të hapur dyqanin komercial .
 - Fletën poseduese nr.552 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Qendra për Kadastër të Pronës së Paluajtshme e Prishtinës, Shërbimi për Pronë Kadastrale të Paluajtshme e Klinës më 27 nëntor 2002 e cila paraqet pronën në emër të B. D.

- Aktgjykimin C.nr.149/06 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Klinës më 22 tetor 2009 me të cilën Gjykata e miraton padinë e B. D.dhe e shpall Kontratën e Shitblerjes Nr. 49/2003 si JURIDIKISHT TË PAVLEFSHME.

Paraqitësja e kërkesës kishte paraqitur shumë dokumente të tjera të cilët nuk ishin relevante për zgjidhjen e kësaj çështjeje ligjore.

3. Në bazë të Aktgjykimit C.nr.149/06 lëshuar nga Gjykata Komunale e Klinës, Zyra Kadastrale dhe e Gjeodezisë e Komunës së Klinës ishte urdhëruar të ndryshoj librat e vet kadastral në përputhje me këtë aktgjykim dhe të kthej mbrapsht ndryshimet që ishin bërë më parë. Kontrata e kontestuar nr. 49/2003 ishte nënshkruar në emër të B. D. si shitës i përfaqësuar nga M. M. në bazë të Autorizimit nr. 16/03 dhe L. M. si blerës ishte shpallë e pavlefshme. Gjykata konstatoj se baza për shitblerjen, Autorizimi, ishte i falsifikuar dhe rrjedhimisht Kontrata e shitblerjes nuk kishte efekt ligjor.
4. Përveç Fletës Poseduese nr. 552 e cila ishte gjetur e azhurnuar në emër të L. M, dokumentet e tjera janë verifikuar pozitivisht.
5. Më 13 shkurt 2009, zyrtarët e AKP-së kanë kryer identifikimin e pronës dhe prona ishte gjetur e uzurpuar nga L. M. (tani e tutje: Pala përgjegjëse), i cili pretendonte të drejtën e pronësisë dhe mori pjesë në kërkesë prandaj kërkesa klasifikohet si e kontestuar.
6. Për të mbështetur pretendimet e tij, ai ka dorëzuar provat vijuese:
 - Autorizimin Nr.16/03, i vërtetuar, siç pretendohet, pranë Gjykatës Themelore të Podgoricës më 6 janar 2003, sipas të cilit B. D. kishte autorizuar M. M. për të vepruar në emër të tij për të lidhur Kontratën e Shitblerjes për sa i takon pronës së kërkuar, transferimin e të drejtës pronësore në emër të blerësit si dhe për të ndërmarrë të gjitha masat juridike në gjykatat relevante dhe institucionet në Klinë.
 - Kontratën e Shitblerjes Nr. 49/2003, të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Klinë më 8 janar 2003. Kontrata ishte lidhur në mes të M.M. si person i autorizuar në cilësinë e shitësit dhe Palës përgjegjëse si blerës i pronës së kërkuar.
 - Transaksionin bankar të datës 8 janar 2003 që tregon se Pala përgjegjëse në ankesë i kishte paguar taksat për transaksionin e blerjes.
 - Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-71010027-00609 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës e cila tregon

pronën e azhurnuar në emër të Palës përgjegjëse me një sipërfaqe të përgjithshme prej 00.30.79 ha.

7. Sipas raportit të verifikimit të datës 11 shkurt 2011, Shefi i shërbimeve verifikuese i Gjykatës Themelore të Podgoricës, ka pohuar se Autorizimi nuk është gjetur dhe as që është lëshuar nga gjykata në fjalë.
8. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka gjetur, sipas detyrës zyrtare, Aktgjykimin e plotfuqishëm Ac.nr.20/2010 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 17 korrik 2013 i cili e vërteton Aktgjykimin C.Nr.149/06 të Gjykatës Komunale në Klinë. Për më tepër, Sekretaria Ekzekutive gjeti Aktgjykimin Rev.nr.200/2011 të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 28 shkurt 2013 i cili refuzon kërkesën e Palës përgjegjëse për revizion të Aktgjykimit Ac.nr.20/2010 të Gjykatës së Qarkut në Pejë i cili e vërteton Aktgjykimin e shkallës së parë C.Nr.149/06.
9. Me vendimin KPCC/D/C/224/2013 të datës 27 nëntor 2013, kërkesa e palës ankuese ishte hedhur poshtë mbi bazën se në përputhje me nenin 11.4 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim të plotfuqishëm administrativ apo gjyqësor.
10. Vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar Paraqitëses së kërkesës më 19 shkurt 2014. Ajo ka paraqitur ankesë më 19 shkurt 2014. Pala përgjegjëse ka marrë vendimin e KKKPK-së më 28 maj 2014 por ai nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës. Ankesa nuk i është dorëzuar Palës përgjegjëse në ankesë, megjithatë, Gjykata Supreme nuk e ka parë këtë të nevojshme sepse kjo nuk do të ndryshoj rezultatin përfundimtar të rastit.

Pretendimet e Palës ankuese

11. Pala ankuese ka kërkuar që kërkesa të rishqyrtohet përsëri duke theksuar se Gjykata Komunale e Klinës ka lëshuar aktgjykimin në të mirë të saj. Pas ankesës së palës përgjegjëse në ankesë, Gjykata e Qarkut në Pejë ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë përsëri. Ajo thekson se Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur dhe një kërkesë për rishqyrtim e cila prapë është vendosur në të mirë të saj. Prandaj, ajo kërkon nga Gjykata Supreme ta ndryshoj vendimin e KKKPK-së dhe të miratoj ri-posedimin në të mirë të saj.

Arsyetimi ligjor

12. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit 30 ditorë siç parashihet me Nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.
13. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, vendimit të ankimuar dhe pretendimeve të palës ankuese, gjeti se ankesa është e pabazuar.
14. Nën parimin *res judicata* lënda nuk duhet të shqyrtohet nga gjykata nëse çështja e njëjtë, me palët e njëjta që marrin pjesë në procedurë, tani më është vendosur nga një gjykatë tjetër. Kjo është situata me rastin aktual, kërkesa e njëjtë ishte paraqitur në Gjykatën Komonale të Klinës dhe në KKPK, gjithashtu edhe palët pjesëmarrëse ishin të njëjtat në të dy procedurat si dhe faktet, baza ligjore dhe çështjet e prova janë krejtësisht të njëjta në të dy kërkesat e dorëzuara në Gjykatën Komonale të Klinës, respektivisht në KKPK.
15. Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së ka qenë i drejtë për sa i përket hedhjes poshtë të kërkesës në kuadër të kufijve të juridiksionit dhe kompetencave të KKPK-së në përputhje me nenin 11.4.c të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe i njëjti vendim duhet të konfirmohet.
16. Bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 166, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
17. Ky aktgjykim është pa paragjykim mbi të drejtën e Palës ankuese për të ndjekur të drejtat e tij në gjykatën kompetente.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it